




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL**  
**MALISHEVË**



06.07.2020

02/231

**RREGULLORE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA**  
**KOMUNALE PËR VITIN 2020**

**Malishevë, Janar 2020**

*Përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa*

## PËRMBAJTJA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME.....	2
II. DISPOZITAT NDËSHKUESE.....	4
1. Drejtoria për Inspektoriat.....	4
Drejtoria e Inspektoratit shqipton këto gjoba mandatore.....	5
III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	5
2. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.....	6
Tarifat e taksave administrative për dokumente.....	6
Tarifat e ngarkesave për shërbime tjera.....	6
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.....	7
Tarifat e ngarkesave vjetore për veprimtaritë e biznesit.....	7
Bujqësia, industria, ndërtimtaria.....	7
Tregtia.....	8
Hotelet dhe Restorantet.....	9
Transporti tokësor.....	9
Veprimtaritë përcjellëse dhe shërbyese.....	10
Arsimi, veprimtaritë profesionale dhe mbrojtja shëndetësore.....	11
Zejtaria.....	11
Caktimi vlerës qarkulluese.....	12
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike.....	12
Renta për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale.....	12
Shfrytëzimi i hapsirave në tregje publike në pronësi të Komunës.....	12
5. Drejtoria për Urbanizëm.....	13
6. Drejtoria për Gjeodozi dhe Kadastër.....	13
Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve (shitblerjes).....	13
Në bazë të dhuratës.....	14
Në bazë të dokumenteve administrative dhe gjyqësore.....	14
Në bazë të pjesimit (ndarjes) së pronës.....	14
Në bazë të trashëgimisë.....	14
Në bazë të ndërrimit (këmbimit) të pronës.....	14
Regjistrimi i h potekave.....	15
Fshirja e hipotekave.....	15
Regjistrimi i servituteve.....	15
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja.....	15
Regjistrimi i barrave dhe ngarkesave të ndryshme.....	15
Korrigjimi i të dhënave në regjistër.....	16
Regjistrimi i të dhënave tjera.....	16
Regjistrimi i njësisve të reja në pjesën tekstuale të krijuara nga ndarja e parcelës në terren nga gjeodet/kompani gjeodezike private.....	16
Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë (sipërfaqe) për ndërtim.....	16
7. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.....	16
8. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.....	17
Tabela e shërbimeve për personat jashtë vendit.....	17
Tabela e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor.....	17
Tabela e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësorë --QKMF dhe QMF.....	18
Tabela e shërbimeve me pagesë në Qendrën për Punë Sociale (QPS).....	19
9. Drejtoria për Arsim dhe Edukim.....	19
10. Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport.....	20
Biblioteka e qytetit.....	20
Shfrytëzimi i Palestrës së sporteve „Habib Zogaj”.....	20
Shfrytëzimi i Shtëpisë së Kulturës „Tahir Sinani”.....	21



Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 pika a,c,g. të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 2 dhe 8 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.88/25 nëntor 2010), dispozitave të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.27/03 qershor 2008), në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja e.h. të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, vendimit nr.02/100 datë: 02.03.2020, ftesës për debat-konsultim publik nr.04/46 datë: 06.03.2020, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e - IV- (katërt) të mbajtur me datë: 29.06.2020 miraton:

## RREGULLORE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2020

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

#### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për obliguesit, mënyra e llogaritjes, lartësia e tarifave, afatet e pagesës, arkëtimi, evidentimi dhe mbikqyrja e ngarkesave, dispozitat ndëshkuese dhe ankesat në ngarkesat e caktuara në bazë të kësaj Rregulloreje.

#### Neni 2

Caktohet lartësia e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor në territorin e Komunës së Malishevës, si:

- 2.1 Personat të cilët paraqesin kërkesë për vërtetime, certifikata të ndryshme, deklarata dhe parashtresa tjera para organeve të Administratës komunale;
- 2.2 Personat fizik dhe juridik, bizneset të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në territorin e Komunës së Malishevës;
- 2.3 Personat të cilët bëjnë bartjen e të drejtës së pronës përmes transaksioneve;
- 2.4 Personat fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale apo kolektive për banim dhe afarizëm;
- 2.5 Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, leje ndërtimore etj;
- 2.6 Personat që kërkojnë ndërrimet e destinimeve të parcelave të tokës;
- 2.7 Personat dhe subjektet, të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës për ndërtim apo pa ndërtim;
- 2.8 Personat apo subjektet, të cilët kërkojnë shërbime të kadastrit dhe gjeodolisë;

*Rregullore për taksë, ngarkesë dhe gjobë komunale për vitin 2020*

- 2.9 Subjektet të cilët merren me shfrytëzimin e resurseve natyrore;
- 2.10 Personat apo subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznes, tregje, parkingje, ekspozim publik të vitrinave reklamuese, lojëra argëtuese etj.:

#### Neni 3

Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen janë pjesë e kësaj Rregulloreje dhe caktohen sipas drejtorive përkatëse.

#### Neni 4

Tarifat e taksave janë shuma fikse, ndërkaq llogaritja (caktimi), dhe pagesa e tyre nga obliguesi bëhet me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e personave të ndryshëm.

- 4.1 Ngarkesat vjetore të caktuara për ushtrimin e veprimtarisë biznesore dhe tatimit në pronën e qytetarëve, paguhet në dy këste të barabarta dhe atë: kësti i parë gjerë më 30 qershor dhe kësti i dytë gjer më 31 dhjetor.
- 4.2 Taksa vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit bëhet deri, më 30 prill të vitit në vijim, dhe më pas sipas paracitjes së rasteve të regjistrimeve e hapjeve të reja të biznesit.
- 4.3 Kriteri i caktimit të taksës komunale vjetore për veprimtaritë biznesore është: kategoria e veprimtarisë që ushtrohet e të cilat përcaktohen me këtë Rregullore.
- 4.4 Subjektet afariste, apo ndërmarrjet e të gjitha llojeve, të cilat e kanë selinë bazë në territorin e Komunës së Malishevës, ndërsa të njëjtën e ushtrojnë në vende të ndryshme në formë të njësive apo përfaqësive afariste në territorin e komunës, obligohen për secilën njësi punuese në shkallën 30% të tarifës bazë.
- 4.5 Ndërmarrjet të cilat në kuadrin e aktiviteteve të tyre afariste, nëpër njësi ushtrojnë veprimtari të llojeve të ndryshme, ngarkohen sipas tarifës për veprimtarinë e caktuar.
- 4.6 Ndërmarrjet të cilat selinë bazë e kanë në komunat tjera të Kosovës, e që në territorin e Komunës së Malishevës kanë të hapur njësitë apo përfaqësitë e tyre, ngarkohen me tarifën bazë të llojit të veprimtarisë.

#### Neni 5

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat në afatet e caktuara te bankat në llogarinë përkatëse të Komunës sipas aktit që bjen Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet për secilin subjekt afarist.

#### Neni 6

Subjekti mund të bëjë ankesë ndaj Vendimit të lëshuar nga komuna, nëse konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës zhvillohet në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 126 e 127 të Ligjit Nr..02/L-28 për Procedurën administrative .

#### Neni 7

Ndaj Vendimit të marrë nga komuna, pala mund të kërkojë të drejtën edhe në procedurë gjyqësore në pajtim me ligjet e zbatueshme në fuqi.

## II. DISPOZITAT NDËSHKUESE

### 1. DREJTORIA PËR INSPEKTORIAT

#### Neni 8

Drejtorja e Inspektoratit pas verifikimit se personi përgjegjës i subjektit afarist nuk e ka paguar taksën komunale me rregull do t'i leshoj vërejtje me shkrim për pagesë të taksës komunale, përndryshe në rast të mos pagesës së taksës komunale pasojnë masat e tjera ligjore.

#### Neni 9

Subjektet afariste apo personat fizik të cilët vendosin pano apo tabela të ndryshme në shtylla të ndryshme, trotuare, buzë rrugëve apo në hapësira publike për reklamime të ndryshme, pa pëlqimin e organit kompetent komunal, do të dënohen me gjobë mandatore prej 50 €. nga Drejtorja e Inspektoratit si dhe do të hiqet dhe asgjësohet panaja reklamuese. Ndërsa në rast të mos pagesës së gjobës mandatore ndaj personit përgjegjës do të iniciohet procedura për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

#### Neni 10

Për tentim të mosdeklarimit të hapësirës së shfrytëzuar biznesore dhe mos paraqitjen e veprimtarisë tjetër që ushtrohet në kuadrin e atij subjekti, ndaj pronarit apo personit përgjegjës do të iniciohet procedura në gjykatën kompetente.

#### Neni 11

11.1 Personi përgjegjës i subjektit afarist, edhe pas vërejtjes së lëshuar me shkrim për vonesë në pagesën e taksës komunale nuk e bën pagesën e taksës Drejtorja e Inspektoratit inicon procedurën në organet kompetente sipas ligjit në fuqi, për mos pagesë të taksës komunale nga personat përgjegjës të subjekteve afariste.

11.2 Procedura sipas nenit 11.1 të kësaj Rregulloreje do të iniciohet për borgjin e mbetur para se i njejtë të mos jetë paguar deri në ndryshimin e kësaj Rregulloreje e cila i ka liruar nga taksat komunale subjektet afariste.

Neni 12

**Drejtoria e Inspektoratit shqipton këto gjoba mandatore**

12.1.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Për transport të udhëtarëve me kombi taksi dhe auto taksi <b>pa leje</b> nga organet kompetente	50 €
2.	Për ekspozim të mallit në vende jo të destinuara	50 €
3.	Për keqpërdorim të ujit të pijshëm	200 €
4.	Për hedhje të mbeturinave në vendin jo të duhur	200 €
5.	Për vendosje të panos reklamuese pa pëlqim nga organet kompetente komunale	100 €
6.	Për mallerat me afat të skaduar dhe të demtura	500 €
7.	Mos parkimi i kompanive transportuese në Stacionin e Autobusëve	50 €
8.	Mos respektimi i orarit të punës nga personat përgjegjës të subjekteve afariste	50 €
9.	Prerja e asfaltit, vendosja e pengesave pa pëlqim nga organet kompetente	500 €

12.2 Për kërkesë të daljes në terren të inspektorëve për vërtetimin e gjendjes faktike paraprakisht në buxhetin e Kuvendit të komunës paguhet tarifa për shërbim, dhe atë:

1. Të gjithë operatorët e telefonisë, bankat dhe organizatat tjera financiare, distributorët e energjisë Tarifa 100 €
2. Kompanitë publike.....Tarifa 50 €

12.3. Për dhënjen e pelqimeve sanitare dhe të kushteve minimale teknike do të jene këto pagesa:

1. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe deri 20 m<sup>2</sup> .....10 €.
2. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe prej 21-50 m<sup>2</sup> .....20 €.
3. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe prej 51-100 m<sup>2</sup> .....30 €.
4. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 100 m<sup>2</sup> .....50 €.

12.4 Për dhënjen e vërtetimeve, konstatimeve dhe dokumente të ndryshme për subjektet afariste pagesa është.....20€.

### III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është tabela e tarifave dhe ngarkesave që zbatohen nga drejtoritë komunale.

Neni 14

14.1 Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore pushon aplikimi i dispozitave në rregulloret dhe vendimet tjera lidhur me tarifën, ngarkesat dhe gjokat komunale që kanë qenë në fuqi gjerë më tani, ndërsa dispozitat tjera që kanë të bëjnë me procedura dhe në rast se paraqiten mungesa juridike, do të mund të zbatohen ato .

14.2 Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë: Rregullorja mbi tatimin në pronë, Rregullorja për Ngarkesat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Neni 15

- 15.1 Tabela e tarifave të kësaj Rregulloreje duhet të miratohet çdo vit gjer më 31 janar nga Kuvendi i Komunës, për të pasur fuqi të plotë dhe legale në grumbullimin e të hyrave për komunën gjatë viti në vijim.
- 15.2 Punët vjetore administrative të kryera nga drejtoritë komunale gjer me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, kanë vlerëshmëri të plotë, ashtu si janë vendosur me dispozitat e rregulloreve atëherë ekzistuese.
- 15.3 Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqi Rregullorja nr.02/560 e dt.24.12.2018.

#### Neni 16

Kjo rregullore gjithëherë duhet të harmonizohet me ligjet dhe udhëzimet administrative të ofruara nga Qeveria e Kosovës për nivelin e komunave.

#### Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe zbatohet gjatë vitit fiskal 2020.

#### Neni 18

## 2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

### Tarifat e taksave administrative për dokumente

18.1.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Çertifikata e lindjes	1 €
2.	Çertifikata e martesës	1 €
3.	Çertifikata e vdekjes	1 €
4.	Çertifikata e aktit të vdekjes	1 €
5.	Çertifikata e vendbanimit	1 €
6.	Çerifikata e personit që është në jetë	1 €
7.	Çerifikata e mbajtësit të familjes	2 €
8.	Çertifikata e shtesës për fëmijë	3 €
9.	Çertifikata e shtetësisë	2 €

### Tarifat e ngarkesave për shërbime tjera

18.2.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Të vërtetuarit autentik të dokumenteve (për faqe)	1 €
2.	Certifikata në bazë të dëshmitarëve	1 €
3.	Vërtetimi për papunësimin	1 €
4.	Deklarata e bashkësisë familjare etj	2 €
5.	Certifikata e statusit martesor	2 €
6.	Regjistrimi me vonesë në LAL (Libri Amzë I të Lindurve)	2 €
7.	Përkthimi dhe vërtetimi i dokumentit	3 €
8.	Certifikata e personit nën kujdestari	3 €

9.	Vërtetim – sqarimi etj. (për nevoja jashtë vendit)	2 €
10.	Anulimet, korigjimet e gabimeve në LAL	2 €
11.	Korigjimi i emrit dhe mbiemrit personal	2 €
12.	Ndërrimi i emërit ose mbiemërit	7 €
13.	Tarifa administrative për dokumentet e marra nga vendet e huaja	2 €
14.	Ceremonia e martesës gjatë orarit të punës	3 €
15.	Ceremonia e martesës jashtë orarit të punës	5 €
16.	Ceremonia e martesës jashtë ndërtesës	7 €
17.	Zhvillimi i procedurës për vërtetimin e ekzistimit të martesës	7 €
18.	Ceremonia e martesës me shtetësi tjetër	20 €
19.	Pjesëmarrja në tender për dhënien e vijave për autobus dhe kombibus	3 €
20.	Regjistrimet me vonesë në LAV	2 €
21.	Ndërrimi i adresës, çlajmërimi i vendbanimit të qytetarit	1 €
22.	Vërtetim i arkivës nga RTH	1 €

18.3. Lirimi nga taksat administrative komunale lirohen rastet e:

1. Asistencës sociale.
2. Familjet e ngushta të dëshmorëve.
3. Invalidët e luftës.
4. Veteranët e luftës.
5. Familjet e ngushta të viktimave civile të luftës.
6. Personat hendikos.
7. Studentët, dhe
8. Të verbërit.

Neni 19

### 3. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

Tarifat e ngarkesave vjetore për veprimtaritë e biznesit;

**Bujqësia, industria, ndërtimtaria**

19.1	Kultivimi i kulturës së drithrave, pemëve dhe perimeve, hortikultura, Këpurdhave, rritja e bagëtive, shpendëve në ferma, gjuetia, peshkimi, veprimtarive, prodhimi ambalazheve e tjera të ngjashme	Tarifa vjetore 0.00 €
19.2	Ekspluatimi në miniera i thëngjillit, zhavorit, rërës, gurit gëlqeror e xeheve tjera të ngjashme klasifikimit standard të veprimtarive	Tarifa vjetore 1,000.00 €
19.3	Prodhimi, përpunimi dhe konzervimi i mishit dhe produkteve të mishit, e të ngjashme, sipas klasifikimit standard të veprimtarive	Tarifa vjetore 0.00 €
19.4	Prodhimi i produkteve të qumështit, miellit, mullinj të elektrik, pijeve, duhanit e të ngjashme.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.5	Prodhimet prej druri i dyerve, dritareve, mobileve, botimi i librave, riprodhimi i disqeve sonore, prodhimi i preparateve farmaceutike.	Tarifa vjetore

*Rregullorë për taksat, ngarkesat dhe gjatësitë komunale për vitin 2020*



	parfumeve, sapuni dhe preparateve kozmetike e të toaletit, produkteve prej gome dhe plastike, prodhimi i produkteve të qelqit, pllakave prej qeramiks, prodhimve prej mermeri, tjegullave, tullave, prodhime me beton bllokave, kubëzave, prodhimi e metaleve dhe produkteve, dritareve, portave metalike dhe nga plastika, prodhimi i makinave dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive.	0.00 €
19.6	Prodhimi i tekstilit, lëkurës, betonit dhe asfaltit e të ngjashme në uzina e prodhime tjera.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.7	Rikuperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jometalike.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.8	Furnizimi me gas e të ngjashme:	
	a) me pakicë	Tarifa vjetore 0.00 €
	b) me shumicë	Tarifa vjetore 0.00 €
19.9	Ndërtim objekteve, ndërtimi i rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit, objekteve sportive, tarsave lumore e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive	Tarifa vjetore 0.00 €
19.10	Meremetimi i ndërtimeve si lysterja, meremetimi i objekteve dhe pjesëve të tyre, vendosja e instalimeve dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive:	Tarifa vjetore 0.00 €

### Tregtia

19.11	Ndërmjetësimi në tregtinë me shumicë të automjeteve motorike, makinave, pajisjeve, apartave, tekstilit, porcelonit dhe produkteve të tjera përveç tregtisë së makinave bujqësore, farërave, plehrave, barërave mjekësore dhe mallrave ushqimore.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.12	Tregtia me pakicë sipas pikës 19.11	Tarifa vjetore 0.00 €
19.13	Tregtia me pakicë e materialit ndërtimor dhe drurit, e plehrave dhe farërave.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.14	Tregtia jo e specializuar me shumicë e ushqimit, pijeve dhe duhanit	Tarifa vjetore 0.00 €
19.15	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara ku shiten artikujt ushqimorë, pijet dhe duhani, si dhe mallra të ndryshme të imëta në kiosqe:	
	a) Minimarketi dhe kioska qytet	Tarifa vjetore 0.00 €
	b) Minimarketi dhe kioska fshat	Tarifa vjetore 0.00 €
	c) Qendrat tregëtare (supermarketet të gjitha llojeve)	Tarifa vjetore 700.00 €
19.16	Tregtia me pakicë e barërave mjekësore, preparative bujqësore, preparative kozmetike, pijeve alkoolike e joalkoolike, e veshjeve (butiqet, sallonet e nuserisë) etj.	Tarifa vjetore 0.00 €

19.17	Tregtia me pakicë e tekstilit dhe tepihave:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.18	Tregtia me pakicë e mobilieve e orendive shtëpiake (sallonet e mobilieve):	Tarifa vjetore 0.00 €
19.19	Tregtia me pakicë e aparateve elektrike, shtëpiake, radioaparateve dhe aparateve TV, artikujve të imët metalike dhe materialit instalues, pjesëve për makina dhe autopjesë:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.20	Tregtia me pakicë e karburanteve dhe derivative të naftës:	
	a) në rrugët rajonale	Tarifa vjetore 100.00 €
	b) në fshatra	Tarifa vjetore 0.00 €
19.21	<b>Tregjet javore</b>	
	a) tregu për automjete	Tarifa vjetore 0.00 €
	b) tregu i gjelbërt	Tarifa vjetore 0.00 €
	c) tregu i plaçkave	Tarifa vjetore 0.00 €
	d) tregu i kafshëve	Tarifa vjetore 0.00 €
	e) tregu i lëndëve drusore	Tarifa vjetore 0.00 €
19.22	Tregtia me pakicë e produkteve tjera në dyqane të specializuara (këpucëve, libraritë, CD shopet, artikujve funeral, etj. të ngjashme):	Tarifa vjetore 0.00 €

### Hotelet dhe Restorantet

19.23	Hotelet dhe motelet me restorant:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.24	Restorantet për organizimin e dasmave, lokalet e natës:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.25	Restorantet	Tarifa vjetore 0.00 €
19.26	Kafiteritë, ëmbëltoret, menzat dhe kuzhinat (gjellëtoret e hamburgerët), diskoklubet e të ngjashme:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.27	Çajtoret:	Tarifa vjetore 0.00 €

### Transporti tokësor

19.28	Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë dhe kompanitë e taksive	Tarifa vjetore 0.00 €
-------	------------------------------------------------------------------------	--------------------------

19.29	Transporti i udhëtarëve me kombibuse	Tarifa vjetore 0.00 €
19.30	Transporti i udhëtarëve me autotaksi	Tarifa vjetore 0.00 €
19.31	Transporti i mallrave, rërës dhe materialeve tjera për ndërtim:	
	a) me maune dhe ndërmarrja transportuese	Tarifa vjetore 0.00 €
	b) autotransportues (kamion)	Tarifa vjetore 0.00 €

### Veprimtaritë përcjellëse dhe shërbyese

19.32	Shërbimet bankare monetare dhe kredituese (filialet e bankave);	Tarifa vjetore 1.000.00 €
19.33	Shërbimet e ndërmjetësimit mikrofinanciar;	Tarifa vjetore 700.00 €
19.34	Shërbimet postale dhe komunikimit dhe telefonik;	Tarifa vjetore 500.00 €
19.35	Shërbimet kabllovike të rrjetit ;	Tarifa vjetore 0.00 €
19.36	Kontrollimi dhe analizat teknike;	Tarifa vjetore 0.00 €
19.37	Veprimtaritë e fotografisë;	Tarifa vjetore 0.00 €
19.38	Ndërmarrjet publike: të pastrimit të qytetit, ujësjellësit, pyjore, banesore	Tarifa vjetore 0.00 €
19.39	Distributorët e energjisë elektrike	Tarifa vjetore 1.000.00 €
19.40	a) Veprimtaritë e agjencioneve të udhëtimit dhe shërbimet tjera për turistë, veprimtaritë e sigurimit të pasurisë dhe personave, parkingjet e automjeteve. b) Transeferet monetare	Tarifa vjetore 0.00 € 0.00 €
19.41	Shërbimet e fitnessit, bilardot e të tjera që ushtrohen brenda	Tarifa vjetore 0.00 €
19.42	Organizimet e lojrave të fatit, bastoret, kazinot, lodrave të ndryshme automatike sezonale në terrene të hapura që sjellin fitim e të ngjashme.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.43	Shërbimet e internetit, tërenet për sporte (sallat), pishinat e të ngjashme	Tarifa vjetore 0.00 €
19.44	Dhënia me qira e makinave, aparteve, skeleve, puna sezonale me makina bujqësore, kombajnerët e të ngjashme, pastrimi kimik i rrobave (tekstileve), fotokopjet dhe veprimtari tjera shërbyese të pa përcaktuara.	Tarifa vjetore 0.00 €

## Arsimi, veprimtaritë profesionale dhe mbrojtja shëndetsore

19.45	Veprimtaritë e shkollave për shofer.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.46	Organizimi i kurseve të gjuhëve , kompjuterit, kurseve plotësuese për aftësim në lëndët e ndryshme, arsimimin e të rriturve me pagesë e të ngjashme:	Tarifa vjetore 0.00 €
19.47	a)Avokatët, përkthyesit, b)Noterët.	Tarifa vjetore 0.00 €
19.48	Konsulentët financiar (kotabilistët), punët juridike pa përfaqësim;	100.00 € Tarifa vjetore
19.49	Stacione: lokale të radios:	0.00 € Tarifa vjetore
19.50	Stacionet lokale me TV:	0.00 € Tarifa vjetore
19.51	Shërbimet specialistike në ordinancë private.	0.00 € Tarifa vjetore
19.52	Qendrat diagnostike.	0.00 € Tarifa vjetore
19.53	Poliklinikat.	0.00 € Tarifa vjetore
19.54	Shërbimet specialistike private njëditore në javë	0.00 € Tarifa vjetore

## Zejtaria

19.55	Frizerët për mashkuj, këpucëtarët, orëtarët, rrobaqepësit etj;	Tarifa vjetore 00.00 €
19.56	a)Vullkanizerët, b)Autolarjet, mekanikët e rtv, elektromekanikët e apartave dhe pajisjeve të amvisnisë, furrëtarët,burekgjinjtë;	Tarifa vjetore 0.00 €
19.57	a) Sallonet e ondilimit për femra, b)Automekanikët, autoelektracistët, autongjyresësit, sallduesit ;	0.00 € Tarifa vjetore
19.58	Artarët, argjendarët:	0.00 € Tarifa vjetore

19.59 Nuk ngarkohet me taksë vjetore ç' do biznes për të cilin është caktuar shuma e tarifës deri në dhjetë euro, ngarkesa bëhet vetëm për bizneset me tarifë mbi dhjetë euro.

19.60 Nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste lirohet çdo biznes për periudhën e vitit të parë në të cilin e bënë regjistrimin.

### Caktimi vlerës qarkulluese

	Ngarkesa për caktimin e vlerës qarkulluese të tregut nga ana e komisionit ad hoc në raste të transaksioneve të pronave dhe hipotekave:	Tarifa
23.32	për parcelë	20 €
23.33	për objekt	40 €

Neni 20

### 4. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

#### Renta për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale

20.3	Renta për eksplotimin dhe shfrytëzimin me gropim të pasurive tokësore e nëntokësore në pronësi të komunës: gurit, xheve, thëngjillit, zhavorit, rërës e të ngjashme për afarizëm;	Tarifa për m <sup>3</sup> 1.50 €
20.4	Shfrytëzimi i përkohshëm me ndërtime të forta për banim apo afarizëm;	Tarifa për m <sup>2</sup> 2 €
20.5	Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike me vendosjen e kiosqeve, objekteve tjera prej montazhi në të cilat kryhet veprimtaria afariste;	Tarifa për m <sup>2</sup> 1.50 €
20.6	Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për qëllime prodhuese industriale;	Tarifa për m <sup>2</sup> 2 €
20.7	Shfrytëzimi i objekteve në pronësi të Komunës si sallat e kulturës stadiumet e vende të ngjashme për manifestime të ndryshme si shfaqje, fushatë, seminare etj.	Tarifa ditore 50 €

Neni 21

#### Shfrytëzimi i hapsirave në tregje publike në pronësi të Komunës

21.1.	Shfrytëzimi i hapsirave në tregun e gjelbërt, të plaçkave, kafshëve e tregje tjera javore:	
a)	për tavolinë shërbyese,	Tarifa ditore 1 €
b)	për automjet (veturë, kombi),	Tarifa ditore 1.50 €
c)	për kamion,	Tarifa ditore 3 €
d)	për kafshë të imta,	Tarifa ditore 0.30 €
e)	për kafshë të trasha,	Tarifa ditore 0.50 €
21.2	Vendosja e standeve të hapura lëvizëse për shitjen e gjërave të imëta, aparateve për akullore, kafë, pije freskuese, librave jo shkollorë etj. të ngjashme:	Tarifa ditore për m <sup>2</sup> 0.50 €
21.3	Ekspozimi i panove (pllakateve) reklamuese për biznes në brezin e rrugëve, pjesën anësore të trotuareve (që nuk paraqesin pengesë për	Tarifa vjetore për

Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjoka komunale për vitin 2020

	këmbësor) e hapësira tjera publike në qytezë (përveç atyre që janë të ngjituranë harmoni (linjë) me murin e objektit):	reklamë (pano) 20 €
21.4	Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist;	Tarifa mujore për tavolinë 2 €
21.5	Ngarkesa në marrjen e automjeteve në vendet e ndaluara nga komuna;	Tarifa për çdo automjet 5 €
21.6	Pagesa për një vijë urbane nga kompanitë e transportit rrugor të udhëtarëve në territorin e Komunës	Tarifa 0.00 €
21.7	Kompanitë e transportit rrugor të udhëtarëve , të cilët kanë më shumë se një vijë urbane pagesa bëhet duke llogaritur çdo vijë	Tarifa për vijë 0.00 €

#### Neni 22

### 5. DREJTORIA PËR URBANIZËM

22.1 Për ndërtimin ose rrënimin e një ndërtese ose strukture tjetër brenda territorit të komunës, vendosen taksa të ndryshme në bazë të sipërfaqes në të cilën ndodhet ose në të cilën do të ndërtohet ndërtesa ose struktura.

22.2. *Koficienti i llogaritjes së taksës administrative për leshimin e:*

- Lejes së Ndërtimit do të jetë: **1.70 € /m<sup>2</sup>**, ndërsa
- Rregullimin e Infrastrukturës do të jetë **151,08 €** për kokë banori, të cilat llogariten sipas udhëzimit administrativ, dhe jepen në tabelën e shpenzimeve dhe bëhen pjesë e kësaj rregullore.

#### Neni 23

### 6. DREJTORIA PËR GJEODOZI DHE KADASTËR

Taksat e Nenit:23 janë të përcaktuara me anë të Udhëzimit Administrativ 05/2012 për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga ZKK (zyrat komunale kadastrale) dhe kompanitë gjeodete të licencuara, dhe Udhëzimit Administrativ 08/2014 për tarifat e regjistrimit të drejtave të pronës së luajtshme nga ZKK.

Këto Udhëzime Administrative janë unike dhe zbatohen nga të gjitha zyrat komunale kadastrale, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

#### Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve (shitblerjes)

23.1	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	për vlerën e transaksionit deri në 10 000 €	20 €
2.	për vlerën e transaksionit prej 10 000 deri në 30 000 €	30 €
3.	për vlerën e transaksionit prej 30 000 deri në 50 000 €	35 €
4.	për vlerën e transaksionit prej 50 000 deri në 100 000 €	50 €
5.	mbi vlerën e 100 000 €, për çdo 50 000 €, por shuma e taksës së përgjithshme	30 €

	nuk mundet ta kalojë vlerën e 300 €.	
23.2	Nëse vlera e kontratës/transaksionit është e pa vlerësueshme	70 €

#### **Në bazë të dhuratës**

23.3 Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme është e caktuar vlera e pronës dhe dhuratëdhënësi është anëtar i familjes, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa prej 30% për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 25.1 (pikat 1, 2, 3, 4,5) të kesaj rregullore.

23.4 Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme nuk është caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa –Tarifa në shumë prej 50 € për çdo pronar – posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.

23.5 Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk është anëtar i familjes së ngushtë dhe nuk është caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet tarifa-taksa prej 80 € për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.

#### **Në bazë të dokumenteve administrative dhe gjyqësore**

23.6 Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën në shumë prej 50 €.

#### **Në bazë të pjestimit (ndarjes) së pronës**

23.7. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjestimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi bëhet duke paguar për secilin person pronarë/posedues, paguhet në shumë prej 20 €.

23.8. Për regjistrimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 € për një akt juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët.

1. Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi paguhet tarifa prej 20 €.
2. Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifën prej 100 €.

#### **Në bazë të trashëgimisë**

23.9 Regjistrimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë bëhet, duke paguar për çdo trashëgimtar paguan taksën në shumë prej 10 €.

23.10 Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare, bëhet duke paguar për çdo anëtar të bashkësisë familjare që bëhet pronarë/posedues, paguan taksën në shumë prej 10 €.

#### **Në bazë të ndërrimit (këmbimit) të pronës**

23.11. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar për secilin pronarë/ posedues, paguan taksën në shumë prej 30 €

*Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2020*

### Regjistrimi i hipotekave

23.12.	Regjistrimi i hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuara me dokumentin e hipotekës dhe atë:	Tarifa
	a) kërkesa (kredia) në vlerën deri 10 000 €,	10 €
	b) kërkesa (kredia) në vlerën prej 10 000 € deri 30 000 €,	20 €
	c) kërkesa (kredia) në vlerën prej 30 000 € deri 50 000 €,	30 €
	d) kërkesa (kredia) në vlerën prej 50 000 € deri 100 000 €,	80 €
	e) mbi vlerën 100 000 €, për çdo 100 000 € tekjalim paguhen edhe nga 30 €, por shuma e taksës nuk mund t'a kaloj vlerën e 400 €.	30 €

### Fshirja e hipotekave

23.13.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Për vendimin lidhur me fshirjen e hipotekës nga regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme,	10 €
2.	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar	30 €

### Regjistrimi i servituteve

	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
23.14.	Regjistrimi i të drejtës së servitutit në regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme	50 €
23.15.	Fshirja e servitutit nga regjistri	20 €

### Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja

	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
23.16	E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vjet	50 €
23.17	E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vjetësh	150 €
23.18	E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje deri në 99 vjet	500 €
23.19.	1. Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit. 2. Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes ose nënqiranë tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është përcaktuar në nenin 23.1 pikat (1,2,3,4,5) të kësaj rregulloreje.	

### Regjistrimi i barrave dhe ngarkesave të ndryshme

23.20.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Për regjistrimin e barrës në tatimin në pronën e paluajtshme	20 €
2.	Për regjistrimin e barrës tatimore	30 €
3.	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkphëshme) që procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private të palës	50 €
4.	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkphëshme) që procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare nga	0.00€

Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjopa komunale për vitin 2020



një organ kompetent për zbatimin e ligjit (prokuroria, policia etj.)	
----------------------------------------------------------------------	--

### Korrigjimi i të dhënave në regjistër

23.21.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Nëse të dhënat duhet të korrigjohen janë futur në regjistër sipas dokumentacionit të dorëzuar nga palët, korrigjimi i tyre	20 €
2.	Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me veprimin e zyrës kadastrale komunale ose nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, atëherë korrigjimi bëhet pa pagesë.	0.00 €

### Regjistrimi i të dhënave tjera

23.22 Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme, e të cilat nuk janë përfshirë me dispozitata e kësaj rregullore do të regjistrohen duke paguar Tarifën në shumë prej 40 €.

### Tarifat e shërbimeve komunale kadastrale

23.22. Ndërrimi i kulturave kadastrale:

a) ndërrimi i kulturës në një ngastër pa matje, 10 €

**Regjistrimi i njësive të reja në pjesën tekstuale të krijuara nga ndarja e parcelës në terren nga gjeodet/kompani gjeodezike private.**

23.23. Për një njësi të re të krijuar paguhet shuma prej 10 €

### Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë (sipërfaqe) për ndërtim

23.24.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa m <sup>2</sup>
	a) për klasët e tokës 1 – 4.	1.00 €
	b) për klasët e tokës 5 – 6.	0.70 €
	c) për klasët e tokës 7 – 8.	0.50 €
23.25	Lirohen nga pagesa e taksës në regjistrim të gjitha mjetet dhe pajisjet bujqësore.	

Neni 24

## 7. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

- 24.1 Kompenzimi për punën se Komisionit në vlerësimin e dëmit në pronën bujqësore, vreshta, male, varreza etj., Tarifa për një rast 10 €
- 24.2 Puna e komisionit në ndryshimin e destinacionit të tokës bujqësore, Tarifa për parcelë 10 €
- 24.3 Çertifikata për proceduara bujqësore, Tarifa 1 €

**8. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE****Tabela e shërbimeve për personat jashtë vendit**

25.1.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1	Plotësimi i formularve për shtesa feminare	5 €
2	Çertifikata e statusit familjar	5 €
3	Çertifikata e mbajtjes së anëtarit të familjes	5 €
4	Plotësimi i formularve që personi është në jetë, që janë pensionera në Botën e jashtme	5 €
5	Plotësimi i vërtetimitave për shtojer Gjermani	5 €
6	Vërtetim për pushim mjekësor në Botën e Jashtme	5 €
7	Vërtetim për rregullimin e pensioneve në Botën e Jashtme	5 €
8	Plotësimi dhe rregullimi i formularve, që është student që I nevojitet për Botën e Jashtme	5 €
9	Plotësimi i formularve për shtesa feminare për Botën e Jashtme	5 €
10	Plotësimet dhe vërtetimet të ndryshme që nevojiten për rregullim Dokumentacioni në Botën e Jashtme	5 €

**Tabela e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor**

25.2.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt. QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1 €
2.	ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, me udhëzim të mjekut të familjes.	2 €
3.	ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, pa udhëzim të mjekut të familjes.	4 €
4.	ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	6 €
5.	medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoret publike.	0.30 €
6.	ultrazëri standard,	2 €
7.	radiografia,	2 €
8.	EKG,	0.50 €
9.	analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina,	1 €
10.	analizat laboratorike (komplet),	3 €
11.	caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	1 €

12.	audiogrami,	1 €
13.	shpërlajra e veshit,	1 €
14.	dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	1 €
15.	dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	1 €
16.	përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim (vetëm në vizitën e parë),	3 €
17.	trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor,	1 €
18.	certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve,	18 €
19.	certifikata e mjekut e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	18 €
20.	dhënia e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumenti tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	5 €
21.	ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj.- për një orë	25 €

**Tabela e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësorë –QKMF dhe QMF**

25.3.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Vizitë e parë stomatologjike,	1 €
2.	RTG i dhëmbit,	1.5 €
3.	Mbushje e përherëshme me amalgamë	4 €
4.	Mbushje e përherëshme me kompozitë	5 €
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë)	5 €
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë)	6 €
7.	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme	6 €
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë)	6 €
9.	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë)	6 €
10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përherëshme	6 €
11.	Rindërtimi konzervativ i dhëmbit me mbushje të përherëshme	6 €
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1 €
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1 €
14.	Vulosja e fisurave	1 €
15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1 €
16.	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3 €
17.	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmb)	1 €
18.	Nxjerrja e dhëmbit	1.5 €
19.	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.5 €
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1 €
21.	Riparimi i protezës (ngjitja).	1.5 €

**Tabela e shërbimeve me pagesë në Qendrën për Punë Sociale (QPS)**

25.4.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Kosovës	8 €
2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	8 €
3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimit	5 €
4	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5 €
5	Caktimi i emërit personal	5 €
6	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	5 €
7	Pëlqim për përfaqësim në gjykatë për fëmijët për trashëgimi, nënshkrimi i kontratave të ndyshme dhe caktimi i kujdestarisë	5 €
8	Vërtetim që pala nuk është në përkujdesjen e kujdestarit të përkohshëm ligjor	5 €
9	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijë, prindërit e të cilëve jetojnë ndaras jashtë shtetit	5 €
10	Mendim për adoptim	5 €
11	Anamneza sociale. (konstatim i gjendjes faktike)	5 €
12	Vërtetim që nuk është përfitues i ndihmës sociale (nga kjo tarif lirohen: familjet që janë në ndihmë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, nxënësit dhe studentët)	3 €
13	Vërtetim që nuk merr ndihmë sociale për shtete të jashtme	5 €
14	Vërtetim për autorizim	5 €

**25.5. Personat dhe subjektet e liruar nga pagesa e tarifës nga QPS:**

1. Rastet sociale (dëshmia nga QPS).
2. Familjet e dëshmorëve të luftës (prindërit, bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare).
3. Invalidët e luftës të shkallës së parë dhe të dytë (dëshmi nga organi kompetent).
4. Viktimat e luftës (prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare).
5. Personat me aftësi të kufizuara (dëshmi e invaliditetit të lëshuar nga organi kompetent).
6. Veteranët e luftës së UÇK-së (dëshmi kartela valide e veteranit).
7. Pensionistët. Shoqata dhe sindikata e pensionistëve.
8. Studentët.
9. Ish të burgosurit politik.

Neni 26

**9. DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM**

**26.1. Për provimet me korrespondencë kandidatët janë të obliguar të paguajnë**

- |                     |         |
|---------------------|---------|
| 1. për paraqitje.   | 20 €    |
| 2. lënda me shkrim. | 0.70 €  |
| 3. lënda pa shkrim. | 0.50 €. |

*Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjoka komunale për vitin 2020*

4. provimi i diplomës,	15 €
5. diploma duplikatë,	1 €
6. dëftesa duplicatë.	1 €
26.2. Për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur vijuesit do të Paguajnë:	
1. për regjistrim të vitit,	100 €
2. për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën,	30 €
3. për diplomë përfundimtare të shkollimit,	20 €
4. për praktikë profesionale,	50 €
5. për ndryshim të lëndëve deficitare,	10 €
6. lëndët me gojë.	1 €
26.3. Për një dokument duplikat të arsimit parauniversitar paguhet:	
1. Dëftesa duplikat për kryerjen e shkollës fillore dhe të mesme të ulët	1 €
2. Dëftesa duplikat për kryerjen e shkollës së mesme të lartë	1 €
3. Diploma duplikat për kryerjen e shkollës së mesme të lartë	1 €
26.4 Çerdhja për fëmijë – Për resgjistrimin e fëmijës në Çerdhe paguhet tarifa mujore	30 €

Neni 27

## 10. DREJTORIA PËR KULURË, RINI DHE SPORT

### Biblioteka e qytetit

27.1. Anëtarësimi vjetor i lexuesit në bibliotekën komunale „ Sokol Kryeziu ” në Malishevë	
1. Nxënësi i shkollës fillore	0.00 €
2. Nxënësi i shkollës së mesme	0.00 €
3. Të riturit	0.00 €

### Shfrytëzimi i Palestrës së sporteve „Habib Zogaj”

27.2. Për shfrytëzimin e palestrës së sporteve, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhet këto tarifa:

27.2.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1	Për stërvitje të klubeve private dhe stërvitje të lira sportive për një orë pa ndriçim	0.00 €
2	Për stërvitje të njëjta për një orë me ndriçim	0.00€
3	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen pa ndriçim	0.00 €
4	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen me ndriçim	0.00 €
5	Për termine tjera nga qytetarët për një orë pa ndriçim	0.00 €

Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjopa komunale për vitin 2020

6	Për termine tjera nga qytetarët për një orë me ndriçim	0.00 €
---	--------------------------------------------------------	--------

- 27.3. Për shfrytëzimin e palestrës së sportit për manifestime dhe ngjarje të ndryshme si:
1. Për ngjarje komerciale: panaire, revy, ekspozita dhe fushata të grupeve politike për orë 50€
  2. Për ngjarje humanitare: seminare edukative, akademi përkujtimore, fushata edukative popullore, evente humanitare të tjera shfrytëzimi i palestrës është gratis.

- 27.4 Te klubet që nuk janë të Komunës së Malishevës, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara t'a shfrytëzojnë palestrën e sporteve në Malishevë për zhvillimin e takimeve (ndeshjeve) duhet të paguajnë për ndeshje tarifën 50 €

### Shfrytëzimi i Shtëpisë së Kulturës „Tahir Sinani”

- 27.5. Për shfrytëzimin e shtëpisë së kulturës, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhet këto tarifa:

27.5	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Përrurime të Librave	0.00 €
2.	Ekspozita Artistike	0.00 €
3.	Koncerte dhe shfaqje të ndryshme	0.00 €
4.	Tubime Elektorale	50.00 €
5.	Akademi përkujtimore, aktivitete humanitare dhe organizime apo manifestime me karakter Kombëtar dhe të ngjashme janë të lira nga pagesa	

### Neni 28

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës së thesarit.

Mjetet e inkasuara mund të jenë si rrjedhojë e dënimeve mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës kompetente.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 02/231

Dt. 01.07.2020

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

*Rrahim Morina*  
Rrahim Morina

Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2020



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

03-2020



04-46.

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 pika c, nenin 40 paragrafi 40.2 pika a) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë: 12.11.2008

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Malishevë me datë: 06.03.2020 bënë këtë:

F T E S Ë

Për debat-konsultim publik të Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.

Debati publik mbahet me datën: 20.03.2020 ditën e Premte në sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar prej orës 10:00.

Debati organizohet në mbështetje të:

Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,


Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008

Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.02/100 datë: 02.03.2020

Mirëpresim kontributin tuaj!

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Valon Mazreku





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/100

Datë: 02.03.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 pika a, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 13 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/20018 për Transparencë në Komuna, nenit 7 paragrafi 1, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/20018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, bazuar në nenin 10 paragrafi 2, nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2, nenin 19 paragrafi 7 pika e, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të vitit 2020 të mbajtur me datë: 28.02.2020 miraton këtë:

V E N D I M

PËR PARAQITJEN NË DISKUTIM PUBLIK RËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E  
DRAFT RREGULLORËS PËR TAKSA NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR  
VITIN 2020

1. Miratohet vendimi për paraqitjen në debat-konsultim publik të Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.
2. Diskutimi publik paraqitet në afat prej 14 ditëve, nga dita e shpalljes-paraqitjes së ftesës në tabelën e shpalljeve publike të Komunës së Malishevës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në Komunën e Malishevës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet  
Arkivit të Komunës  
MAPL-së  
Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

